



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 15.9. 2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Fadil Demaku, nënkryetar i parë, Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami, Nuredin Ibishi dhe Zafir Berisha, anëtarë.

Përfaqësuesit nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës: Gjenerallejtënant Rrahman Rama, Shkelzen Sylja, sekretar i përhershëm i Ministrisë, Dominic-Haydn Braithwaite-zëvendësudrejtor i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK-në dhe FSK-në (NALT) , Svein Eriksen-Qendra për Integritetin në Sektorin e Mbrojtjes(CIDS) të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë, Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Florian Qehaja-QKSS, Skender Parteshi-QKSS, Dhurata Kryeziu-OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

Prezantimi i Planit të Integritetit para Komisionit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen, duke thënë se qëllimi i këtij takimi është prezantimi i Planit të Integritetit nga përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së, të cilin do ta paraqes Gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i FSK-së, fillimisht njoftoi për disa aktivitete të FSK-së duke vazhduar tutje me prezantimin disa aspekteve të planit të integritetit. FSK-ja është duke e vazhduar punën, duke u bazuar në mandatin që ka, në forcimin kapaciteteve të veta në mbështetje të autoriteteve civile, me ç'rast është vazhduar në trajnimin profesional të personelit, për të qenë të gatshëm për të vepruar në vend dhe regjion.

Rama gjithashtu njoftoi që është mbajtur bordi i avancimeve, duke filluar nga grada e nënkolonelit, deri tek togeri dhe bordi ka marrë vendime duke u bazuar në performancën dhe të arriturat e eprorëve, ku janë realizuar shtatëdhjetë e pesë avancime, por ka pasur edhe lëvizje horizontale sipas nevojave të shtruara nga njësia. Ndërsa, bordet e tjera për gjeneralë janë më specifike dhe për këtë gjë janë në proces, ku janë në pritje të konsultimit edhe me Presidentin. Gjatë këtij viti është vazhduar me rekrutimin e kadetëve, ndërsa për në Qendrën për Studime Universitare janë përzgjedhur 15 kandidatë, me ç'rast kanë aplikuar pesëqind kandidatë në total. Tre kadet janë përzgjedhur për të qenë pjesë e Akademisë Gjermane, ndërsa dy kadet kanë filluar tashmë Akademinë Ushtarake në West Point të SHBA-së, ndërsa një në Angli dhe një në Kroaci. Vlen të theksohet që janë katër të diplomuar në Akademinë e Mbrojtjes së Maqedonisë (dy nga komuniteti serb dhe dy nga komuniteti boshnjak).

Ftesa të rëndësishme ka pasur për ushtrime të përbashkëta regjionale, me ushtrinë amerikane, që është mbajtur në Gjermani, ftesa është pranuar për ushtrimin “*immediat response*” në Kroaci dhe Slloveni, ndërsa në Shqipëri ushtrimin “*Join Effort*”, që do të fillojë javën e ardhshme.

Gjatë këtij viti është arritur përparim, në bashkëpunimin dhe koordinimin edhe me KFOR-in, me ç'rast është realizuar ushtrimi fushor në fazën e parë, ndërsa pjesa e dytë fillon në nëntor.

Vlen të theksohet, që në këtë vit janë bërë të gjitha planet për ushtrimin fushor “Shqiponja 5”, që do të mbahet në Kosovë, ku pjesë e këtij ushtrimi do të jenë ushtria amerikane për Evropë, Garda Nazionale e Iowa-s (Ajovas) edhe pjesëtarët e KFOR-it. Po ashtu janë ftuar edhe vendet e rajonit për të marrë pjesë, ku është rritur bashkëpunimi me Gardën e Ajovas. Në vitin e kaluar janë realizuar dyzetë e katër aktivitete të përbashkëta. Bazuar edhe në planet bilaterale me SHBA-në dhe shtetet e tjera, është dërguar personel ushtarak për trajnim, që ndihmon në ngritjen profesionale të FSK-së.

Rama theksoi për togerin e FSK-së, që ka pasur një aktakuzë të ngritur në SHBA dhe i cili tashmë është liruar nga të gjitha aktakuzat dhe do të kthehet në Kosovë. Bashkëpunimi me Ajovan ka ndikuar në fushën e mjekësisë dhe në fusha të tjera, është vazhduar trajnimi nga niveli më i ulët deri në nivelin më të lartë dhe tashmë është bërë plani për vitin 2017 për aktivitete e bashkëpunimit me SHBA-në.

Ndërsa, sa i përket transformimit të FSK-së, Rama theksoi që FSK-ja ka marrë të gjitha masat dhe ka përgatitur të gjitha planet, ku janë mbështetur nga ekipet e NALT (Nato Advasy Leasson Team). Gjithçka është bërë në koordinim të plotë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe kurdo që merret vendimi politik, janë të gatshëm në implementimin e planeve të planifikuara.

Po ashtu, Rama theksoi që për tre vjet rresht, FSK-ja është institucioni më i respektueshëm, kjo ka ardhur si rezultat i punës dhe mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë.

Gjatë këtij viti, Ministria e FSK-së në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë ka përgatitur Strategjinë për ngritjen e Integritetit.

Shkelzen Syla, sekretar i përhershëm i Ministrisë së FSK-së, në fillim të fjalës së tij, theksoi që Ministria e FSK-sa i ka realizuar mbi 95 për qind të aktiviteteve të planifikuara dhe opinioni i auditimit është pozitiv. Opinionet e tyre merren në konsideratë dhe janë duke u implementuar. Ndërsa sa i përket ekipit të NALT, është duke u udhëhequr nga një gjeneral gjerman. Në kuadër të planit afatgjatë zhvillimor janë të parapara nevojat buxhetore për implementimin e planit afatgjatë zhvillimor, ndërsa në fund të muajit gusht është mbajtur dëgjimi buxhetor me Ministrinë e Financave dhe përfaqësuesit e tjerë, ku janë shpalosur kërkesat buxhetore për Ministrinë e FSK-së. Plani i buxhetit për vitin 2017 dhe korniza afatmesme 2017-2019, përkon plotësisht me deklaratën financiare, e cila është dërguar për miratim tek ministri i financave në rast të marrjes së vendimit për transformimin e FSK-së.

Sa i përket Planit të Integritetit, Syla theksoi që Qeveria Norvegjeze ka lansuar disa projekte për ngritjen e integritetit në shtetet e Evropës Juglindore, ku fillimisht për Ministrinë e FSK-së është bërë studimi i fizibilitetit dhe është bërë kërkesë që për Ministrinë e FSK-së të jepet mbështetje për hartimin e Planit të Integritetit, i cili përbën kriter për anëtarësim në NATO. Plani i Integritetit është i ndarë në disa fusha, duke ulur mundësinë për keqpërdorime, duke filluar nga keqpërdorimi i burimeve njerëzore, luftimi i keqpërdorimeve të ndryshme, parandalimi i konfliktit të interesit, përmirësimi i sistemit të prokurimit, menaxhimi i aseteve si dhe fuqizimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm. Prej datës 1 korrik 2016, ka filluar implementimi dhe në raportet vijuese, do të jetë pjesë implementimi i rekomandimeve të dala nga plani i ngritjes së integritetit.

Nënkolonel Sefer Isufi, shef i Sektorit për Programe, Plane dhe Analiza në kuadër të Departamentit për Politika dhe Plane në MFSK, theksoi që grupi punues i përbërë nga profesionistë ka zhvilluar dhe e ka bërë pjesë të akteve të brendshme të Ministrisë së FSK-së politikën bashkëkohore të NATO-s, aspektin e integritetit. Programi i ndërtimit të integritetit, fokusohet në zhvillimin e mjeteve praktike për të ndihmuar pjesëmarrësit në forcimin e integritetit, transparencës dhe për reduktimin e korrupsionit në fushën e sigurisë. Plani i Integritetit është një mjet për të hartuar dhe zbatuar masa specifike për të identifikuar rreziqet e korrupsionit.

Me vendim të ministrit të FSK-së, është themeluar Komisioni Këshillëdhënës në përbërje të sekretarit të Ministrisë së FSK-së, përfaqësuesit të Ekipit Këshillues të NATO-së dhe përfaqësuesit të Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes. Roli i tyre ishte në dhënien e këshillave gjatë ngritjes së Planit të Integritetit dhe është zhvilluar në bashkëpunim me autoritetet ushtarake të NATO-s, i miratuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut

Plani i integritetit është një mjet për të hartuar dhe zbatuar masa specifike për të korrigjuar rreziqet e korrupsionit dhe të metat e tjera në sistemin e integritetit. Objektivat kryesore të këtij projekti janë fuqizimi i kornizës së integritetit në Ministrinë e FSK-së dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë, që është në funksion të ndërtimit të kornizës ligjore, reduktimit të rreziqeve ligjore dhe institucionale të korrupsionit në MFSK dhe mbështetja e Ministrisë në ndërtimin e këtij plani për mënjanimin e rrezikut nga korrupsioni dhe mashtrimi. Mekanizmat implementues për këtë projekt, me vendim të ministrit të FSK-së, që në fillim është themeluar Komisioni Këshillëdhënës, në përbërje të sekretarit të Ministrisë së FSK-së,

përfaqësuesit të ekipit këshillues të NATO-s dhe përfaqësuesit e Qendrës për Integritet në sektorin e mbrojtjes. Plani i integritetit është plan parimor, që ka për qëllim reduktimin e rreziqeve dhe dukurit negative në institucion si dhe fuqizimin mekanizmave që luftojnë shfaqjen e dukurive përkatëse. Fokusimi është bërë në fushat e mbikëqyrjes parlamentare, politikat kundër korrupsionit, organet e specializuara të korrupsionit, mekanizmat për parandalimin konfliktit të interesit, mekanizmat për qasje në dokumentet zyrtare, mekanizmat për kontrollin e brendshëm, Zyrën e Auditorit të Jashtëm, avokatin e popullit, prokurimin publik dhe menaxhimin burimeve njerëzore dhe pas analizimit të këtyre fushave është konstatuar se fushat më sensitive janë, sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore në synim fuqizimin e tij, konflikti i interesit me synim parandalimin e tij, sistemi i prokurimit dhe menaxhimit të aseteve , me synim të përmirësimit të tij si dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm për fuqizimin tyre dhe në funksion të këtij procesi.

Qendra për Integritet në sektorin e mbrojtjes ka realizuar tri raporte specifike, lidhur me sistemin e prokurimit, kontrollin e brendshëm dhe konfliktit të interesit dhe krahas angazhimit të anëtarëve të grupit punues, janë nxjerrë propozimet, për masat e ngritjes së integritetit dhe për secilën fushë janë propozuar masat.

Shkelzen Syla, sekretar i përhershëm i Ministrisë së FSK-së, shtoi se Ministria e FSK-së është institucioni i parë që ka filluar me një plan të tillë dhe nga data 1 korrik 2016 , ka nisur implementimi i tij. Për zbatimin e tij, Komisioni do të njoftohet përmes raportimeve periodike.

Ganimete Musliu, theksoi se është vërejtur anashkalimi i Komisionit në këtë proces, ndërsa sa i përket çështjes së gradimeve ajo shtroi pyetjen se a do të ishte e mundur që gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për avancim, njëri nga anëtarët e Komisionit të jetë në cilësinë e vëzhguesit? Ndërsa kur i referoheni ngritjes në karrierë, thuhet se është legjislacioni solid, ku do të duhej të bëhet ndryshimi apo plotësimi në legjislacionin aktual?

Rexhep Selimi, theksoi që plani i paraqitur është i mirë dhe çmon punën e bërë, por Komisioni pret planin për transformimin e FSK-së në ushtri. Edhe pse Ministria nuk është ajo që jep përgjigjeje në këtë çështje, Komisioni është i gatshëm të jep kontributin për këtë transformim, duke theksuar që edhe prezenca e ministrit do të ishte e dobishme.

Ndërsa, sa i përket Planit të Integritetit të prezantuar, Selimi pyeti nëse është përcaktuar përmirësimi i sistemit të prokurimit publik, ku kanë qenë mangësitë në këtë proces dhe çfarë është dashur të bëjë Komisioni?

Nuredin Ibishi, tha se e vlerëson punën e bërë në ndërtimin e Planit të Integritetit, por anashkalimi i Komisionit në këtë proces nuk është dashur të bëhet, pasi ka pasur vërejtje që do t'i kontribuonin këtij plani.

Cili është roli i Komisionit në aspektin e mbikëqyrjes së këtij plani? Përveç fushave të cekura, Ibishi theksoi se ka vërejtje, pasi vetëm plani është i përgjithësuar në krahasim me aspektet e paraqitura. Nga vizitat studimore të bëra për këtë qëllim, çfarë kanë shtetet tjera përveç Planit të Integritetit?

Zafir Berisha, lidhur me aspektin e trajnimeve dhe avancimeve të kuadrove të FSK-së, theksoi që përveç investimeve që bëhen për trajnimin, si brenda dhe jashtë vendit, ka një kufizim të

moshës për të qenë pjesë e FSK-së, ku në bazë të Ligjit pasi të kalon moshën e caktuar duhet të pensionohet edhe pse mund të jep kontribut, pasi është investuar në këto kuadro.

Fadil Demaku, vlerësoi që Plani i Integritetit që u paraqit është dokument i domosdoshëm në rrugën e integritetit dhe përfshinë objektivat e domosdoshme, që duhet ti ketë një ushtri për të qenë pjesë e aleancës së NATO-së. Sa i përket objektivave, Demaku theksoi që nuk e ka përcaktuar sa janë sfiduese, pasi ka çështje që janë të diskutueshme, por e rëndësishme është që ky plan është bërë me mekanizmat ndërkombëtarë në rrugën e integritetit në BE dhe mekanizmat e tjerë. Ndërsa, çështja e mospërfshirjes së Komisionit nuk është esenciale, pasi duke marrë parasysh rolin mbikëqyrës të Komisionit, Ministria është e obliguar të raportojë.

Qerim Bajrami, pasi e vlerësoi punën e bërë për përgatitjen e Planit të Integritetit për Ministrinë e FSK-së, theksoi, që përfaqësuesit boshnjakë e përkrahin transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur, ndërsa sa i përket përfaqësimit të komunitetit boshnjak në FSK, tha që janë të pakënaqur.

Gjithashtu, në kuadër të planit të integritetit, është dashur të përfshihet edhe përfaqësimi i komunitetit jo shumicë si dhe integritimin e pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë në FSK.

Në pjesën ku i referohet avancimit të pjesëtarëve të FSK-së, ku kërkohen aftësitë adekuate, për këtë kërkoi që të përfshihen në trajnime edhe pjesëtarët e këtij komuniteti, ndërsa mospërfshirja e komuniteteve jo shumicë, do të nxiste krijimin e ndonjë formacioni tjetër, gjë e cila nuk përkrahet nga ana e tyre.

Bojan Mitiq, tha se sa i përket transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur, shtroi pyetje për ministrin dhe Komandantin. A janë bërë bisedime për këtë çështje me serbët për integritimin e tyre në strukturat e FSK-së? Në mbledhjen e fundit të Komisionit, lidhur me këtë temë është thënë që nuk ka pasur bisedime për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur. A është bërë ndërkohë diçka në këtë aspekt? Nëse po, çfarë është bërë? Ndërsa sa i përket rekrutimit të kadetëve të rinj, a ka pasur pjesëmarrës në këtë proces nga serbët apo jo?

Svein Eriksen, këshilltarë i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë, pasi falënderoi për mundësinë që të jetë prezent në këtë mbledhje, theksoi që puna më e madhe në përgatitjen e këtij Plani të Integritetit është bërë nga Ministria e FSK-së, ndërsa roli i tyre ka qenë këshillues. Eriksen theksoi që dokumenti i hartuar përbën afatin kohor dhe karakteristikat në bazë të të cilit do të zbatohet.

Gjenerallejtnant Rrahman Rama, tha se sa i përket mospërfshirjes së Komisionit gjatë procesit, kjo është çështje e brendshme e Ministrisë, ndërsa sa i përket bordeve për avancime, janë disa lloje të bordeve, duke u bazuar në rregullore dhe ligje dhe emërohet nga komandanti i FSK-së dhe nënshkruhet nga komandanti. Ndërsa, sa i përket objektivitetit të procesit, janë të hapur dhe çdo anëtarë i Komisionit mund të marrë pjesë. Rreth përgatitjes së planeve, duke iu referuar pyetjes së z.Rexhep Selimi, Rrahman Rama theksoi që janë përgatitur planet përfshirë edhe planifikimin e buxhetit, ku pas transformimit planifikohen ndryshime, përfshirë edhe llojin e armatimit, duke shtuar që çështja e transformimit është më shumë politike.

Për çështjen e prokurimit, edhe vendet e rajonit kanë ligj më specifik për këtë çështje për faktin që ka pajisje specifike, sa më i lartë standardi i mjeteve është problematike çështja e mirëmbajtjes. Ndërsa sa i përket çështjes së pensionimit të pjesëtarëve të FSK-së, theksoi që ligji

i miratuar në Kuvend ka paraparë që mosha për nën oficer është pesëdhjetë vjet ndërsa për oficer është pesëdhjetë e pesë vjet, dhe pavarësisht faktit që investohet në ta, është ligji aktual që e përcakton këtë çështje, por vlerësoi që në të ardhmen duhet të shikohet kjo çështje.

Ndërsa, sa i përket përfaqësimit të komuniteteve në kuadër të FSK-së, sipas statistikave që posedon dhe që është në personelin e Ministrisë së FSK-së dhe se janë të përfshirë në trajnime, duke shtuar që janë të hapur për të dhënë informacione për këtë çështje, por nuk e kupton se ku është problemi.

Rreth çështjes së transformimit të FSK-së, Rama theksoi se nga ana e ministrit janë bërë ftesa për takim nga radhët e partisë serbe, por që nuk i janë përgjigjur ftesës, gjithashtu takime janë realizuar edhe me komunitetet tjera. Ndërsa, në një takim, ku ka qenë pjesëmarrës, takim i thirrur nga zëvendëskryeministri Hashim Thaçi, prezent ka qenë zëvendëskryeministri Stojanoviq, ministri Jevtiq dhe ministri Mariq, është raportuar se çfarë është bërë deri tani.

Në rekrutimin fundit nuk ka pasur kandidatë nga komuniteti serb, ndërsa për të vazhduar studimet në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, është përzgjedhur një kandidat nga komuniteti serb, kurse në Akademinë e Kosovës nuk ka pasur, pasi kriteri për gjuhën është gjuha angleze.

Kryesuese- Sa i përket investimeve milionësh në objekte për tu përdorur si kazerma për FSK-në, dhe për të cilat nuk dihet autori. A është ndërmarrë diçka për bartjen e pronës në pronësi të FSK-së? Duke shtuar se kjo çështje duhet të mbyllet urgjentisht.

Shkelzen Syla-Sekretar i Përhershëm i Ministrisë së FSK-së- Në përgjigjeje të pyetjes së znj.Ganimete Musliu, për legjislacionin solid, theksoi që është fjala për Ligjin e Prokurimit publik, për blerjen e pajisjeve speciale me procedura të veçanta të prokurimit. Propozimi është bërë tek Ministria e Financave që me akte të tjera nënligjore të plotësohet kjo pjesë, por kjo është e rëndësishme që kjo çështje të bëhet në momentin e transformimit të FSK-së në forca të armatosura.

Sa i përket raportimit lidhur me zbatimin e planit të integritetit, theksoi që është pjesë e planit të veprimit për vitin 2016 dhe vitet në vijim, dhe raportimi do të bëhet në mënyrë periodike ku do të përfshihet edhe aspekti i integritetit. Ndërsa sa i përket çështjes së minoriteteve, theksoi se janë në fazën finale të përgatitjes së politikave dhe në pritje për tu miratuar nga Ministri dhe në bazë të tyre të hartohet strategjia për komunitete jo shumicë në Kosovë. Ndërsa sa i përket përqindjes, dhe numrit të pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë, theksoi se janë të gatshëm të japin çdo informacion.

Daut Haradinaj, kryesues, kërkoi sqarim nëse është dërguar në Qeveri ndonjë Projektligj lidhur me transformimin FSK-së në Forca të Armatosura, si dhe deklarata financiare e cila nuk ka marrë mbështetje.

Shkelzen Syla, sekretar i përhershëm i Ministrisë së FSK-së, theksoi që nuk janë dërguar në Qeveri projektligje, por është dërguar deklarata financiare në Ministrinë e Financave, ndërsa sa i përket çështjes së pronësisë së kazermave, shtoi se ashtu si janë bartur nga TMK-ja janë në shfrytëzim. Kanë qenë pesëdhjetë objekte, por gjatë transformimit nga TMK-ja në FSK, janë liruar dhe me marrëveshje të mirëkuptimit i janë dorëzuar Ministrisë së Administratës Publike. Aktualisht janë në shfrytëzim shtatë kazerma, për të cilat nuk posedohet dokument zyrtar. Në nivel të Qeverisë është formuar grupi punues, i kryesuar nga Ministria e Drejtësisë, dhe janë

duke punuar në hartimin e legjislacionit për të mundësuar bartjen e pronësisë, jo vetëm për këto objekte, por për të gjitha objektet që kanë të njëjtën të kaluar.

Zafir Berisha, shtoi që e ka të qartë se në bazë të Ligjit është e rregulluar çështja e pensionimit të pjesëtarëve të FSK-së, por deshi të dijë nëse është i mundur rregullimi i kësaj çështje me ndonjë akt nënligjor për ti dhënë mundësi që të kontribuojnë edhe pas pensionimit oficerët e trajnuar.

Daut Haradinak, kryetar i Komisionit, falënderoi për paraqitjen e përfaqësuesve të Ministrisë së FSK-së dhe me këtë pikë të rendit të ditës e përfundoi mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj